

VENDIM
Nr. 255, datë 23.8.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK “TEKSOEN 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/1 prot., datë 18.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik ‘Teksoen 1’, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.8.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s një pagesë më të vogël se ajo e parashikuar në aneksin A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në vijim do të njoftohet subjekti që të kryejë pjesën e mbetur të pagesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, gjerat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 2.1

- Germa “a”: Aplikuesi duhet të plotësojë shtojcën 2 me informacion mbi llojin e paneleve, nëse janë *on shore* apo *off shore*.

- Aplikuesi duhet të bëjë saktësimet përkatëse për jetëgjatësinë e pritshme të centralit, nga do të varet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.

- Duke qenë se shoqëria ka parashikuar të fillojë punimet në vitin 2023, por në kuadër të vlefshmërisë dhe VNM-së paraprake të depozituar në ERE, vlerësohet t’i kërkohej informacion nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti